



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.340/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut me seli ne Prishtinë, kundër debitorit subjekti ekonomik “HIB Petrol” shpk, me NUI: 810662834 me seli ne Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.935/23 të datës 11.10.2023 me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit subjekti ekonomik “HIB Petrol” shpk, me NUI: 810662834 me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.935/23 i datës 11.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin KPPP.nr.935/23 të datës 11.10.2023 e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit subjekti ekonomik “Al Petrol” shpk, me seli ne fshatin Vragoli, komuna e Fushe Kosovës, i paraqitur kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit P.nr.279/2021 të datës 02.11.2021, i lëshuar nga zyra e Përmbaruesit Private Emine Sherifi – Lubeniqi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 01.11.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit permabrimor aktvendimit, nr.5796 te dt.12.08.2021 te Qeveria e Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut me seli ne Prishtinë, i cili ka marre forme të prerë dhe është bërë i ekzekutueshëm nga data 28.10.2021

Përmbaresit private Emine Sherifi – Lubeniqi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.279/2021 dt.02.11.2021, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër te gjobës, te i paguaje ne xhirollogarinë e Buxhetit te Kosovës shumën ne total prej 1,000 euro, si dhe pagesën e shpenzimeve tjera përmbarimore deri ne pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 11.11.2021, duke theksuar aktvendimi si dokument përmbarimore është marre ne kundërshtim me gjendjen faktike, eshte marre ne kundërshtim dispozitat e LPP-se, ka qene i panevojshëm, i gabuar dhe se nuk përkon me gjendjen faktike. Andaj propozon qe gjykata, këtë urdhër përmbarimor ta anuloj ne tërësi.

Ndaj prapësimit te debitorit, kreditori ka parashtruar përgjigje ne prapësim me, duke arsyetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, se vendimi qe përbën dokument ekzekutiv është i ligjshëm dhe se drejte është konstatuar gjendja faktike andaj propozon e gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin për lejimin e përmbarimit ta vërtetoj

Gjykata Komerciale e Kosoves, Dhomat e Shkalles se Dytë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.935/23 i datës 11.10.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së pretendimet e debitorit janë te pabazuara pasi bazuar ne shkresat e lëndës shihet se propozimi për përmbarim është ne pajtim me nenin 69 dhe 71 si dhe ne pajtim me nenin 21 dhe 22, te LPP, se debitori ka qenë i obliguar ti paguaj prestimin ne përputhje me titullin ekzekutiv.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaresit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarimor aktvendimit, nr.8082 te dt.29.10.2020 te Qeveria e Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut me seli ne Prishtinë, i cili ka marre forme të prerë dhe është bërë i ekzekutueshëm nga data 28.10.2021 ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 dhe 22 të njëjtit ligj.

Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.340/24, me datë 05.06.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**